

E moshuara ne pamundesit per te aplikuar ne portalin e-albania, pas mbarimit të afatit të përdorimit të Pasaportes Biometrike

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasja S.B, banuese ne Njësinë Administrative nr.9, në përmbajtjen e së cilës ankohet për mosdhënien e së drejtës për të dhe bashkëshortit të saj, për të aplikuar për pajisjen me pasaportë biometrike pas afatit 10-vjeçar të përdorimit.

Janë pajisur me pasaportë biometrike në muajin Qershor 2011. Duke qenë se mbaronte afati i përdorimit të saj, ka aplikuar nëpërmjet platformës ALEAT për të caktuar datën e takimit.

Duke qenë se janë të moshuar, jetojnë vetëm dhe me probleme shëndetësore, veçanërisht bashkëshorti i saj, i cili ka probleme me shikimin dhe vështirësi në lëvizje, aplikimi përkatës u bë i mundur nga fqinjët e tyre. Përpos këtij fakti, ata nuk kanë mundësi për të kryer procedurat online.

Pas caktimit të datës për takim, me shumë vështirësi në lëvizje, janë paraqitur pranë Zyrave Aleat dhe i kanë dërrëzuar personit pritës dy pasaportat, kartat e identitetit dhe dy kuponat, por kanë marrë përgjigje se aplikimi duhet të kryhet nëpërmjet portalit e-albania, sepse kanë ndryshuar procedurat e riaplikimit dhe duhet të nisnin dokumentacionin si aplikim për herë të parë, për të plotësuar Formularin e vetëdeklarimit me fotografi.

Ankuesja shprehet se nuk ata dinë të aplikojnë dhe për të kërkuar të drejtën e tyre, i janë drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit.

Në analizë të akteve të nxjerra për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë biometrike, kemi konstatuar se:

Udhëzimi nr.289 datë 02.09.2020 “Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar së fundmi më datë 16.12.2020, në pikën 2 ka përcaktuar:

- “2.Shtetasi, i cili aplikon për herë të parë për t’u pajisur me pasaportë biometrike sipas gërmës a të pikës 1 të këtij udhëzimi, plotëson on-line nëpërmjet portalit e-albania, formularin e vetëdeklarimit me fotografi. Formulari i vetëdeklarimit on-line i përcillet elektronikisht Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Formularin e vetëdeklarimit on-line, e plotësojnë dhe shtetasit që nuk aplikojnë për herë të parë, të cilët janë pajisur me pasaportë biometrike para datës 31.12.2011”.

Në këtë akt nënligjor janë përfshirë të gjitha kategoritë e shtetasve shqiptarë, pa përjashtuar asnjë grup shoqëror, kategorinë e të moshuarve dhe me probleme shëndetësore, të cilët, përpos faktit të vështirësisë për aplikim të formularit të vetëdeklarimit, duhet të shkojnë për të plotësuar edhe një nga procedurat për pajisje me pasaportë biometrike, fotografitë.

Duke marrë shkas nga kjo ankesë, e cila prek një numër të konsiderueshëm të popullatës, pensionistë, persona me aftësi të kufizuar në lëvizje dhe shikim, të cilët janë pajisur njëherë me pasaportë bimetrike dhe me shumë mund paraqiten në zyrat ALEAT për riaplikim si dhe në kushtet që ata janë vetë prezent, në muajin Shkurt 2021 i sugjeruam Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile që këto kategori të përjashtohen nga aplikimi online në platformën e-albania.

Në përgjigje të sugjerimit, u informuam se konstatimet dhe sugjerimet e institucionit tonë janë të drejta, të cilat u pasqyruan Urdhërin nr.488 datë 28.05.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për zbatimin e Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.289 datë 02.09.2020 “Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë”.

Në pikën 5 të këtij Urdhëri, është parashikuar që të gjithë shtetasit, të cilët kanë pamundësi plotësimin e formularit të vetëdeklarimit për pajisje me pasaportë nëpërmjet portalit e-albania, mund të aplikojnë fizikisht në zyrat e Komisaritit të Policisë, ku aplikuesi është i regjistruar në Regjistrin Themelr të Gjendjes Civile.